

Fjala e Rektorit Bajram Kosumi në nëntë vjetorin e UKZ

10 mars 2022

1. Pika më e fortë 2021: akreditimi institucional dhe ri/akreditimi i 9 programeve studimore

Viti 2021, përkundër vështirësive me Pandeminë COVID 19, është viti i sukseseve më të mëdha të UKZ në procesin e akreditimit.

- Akreditimi për herë të tretë i institucionit
- Akreditimi i disa programeve master
- Akreditimi deri në pesë vjet i disa programeve.
- Akreditimi dhe riakreditimi i 9 programeve studimore.

Covid 19 nuk arriti të na pengojë, sado shumë me vështirësi, pothuajse në asnjë proces akademik: me metoda hybride të mësimit (fizikisht dhe online) UKZ ka funksionuar pa shkëputje, studentët kanë ndjekur ligjëratat, janë organizuar provimet, studentët kanë diplomuar, stafi akademik dhe administrativ është avancuar, cilësia është ruajtur e në disa drejtime është shtuar, në rrafshin ndërkombëtar janë zhvilluar projekte të reja, janë rinovohen dhe krijuar hapësira të reja të objektit, laboratorë të rinj etj.

2. Sigurimi i Cilësisë

Cikli i sigurimit të cilësisë përfshin aktivitete në funksion të sigurimit të cilësisë së programeve studimore, proceseve mësimore, cilësinë e punës kërkimore shkencore, cilësinë e ligjëratave, kriterëve të zgjedhjes dhe avancimit së kuadrit akademik, cilësinë e teksteve mësimore, pjesëmarrjes në projekte dhe të tjera.

Për realizimin e synimeve të strategjisë, UKZ-ja harton çdo vit Planin e Veprimit të UKZ-së dhe Planin e Veprimit për Cilësi, duke përditësuar të gjitha aktivitetet, që shkojnë në dobi të realizimit të objektivave të parapara në strategji.

Zyra për Cilësi ka krijuar:

- *Plani Zhvillimor Individual (PZHI)*

Planet zhvillimore individuale përmbajnë objektivat e vlerësimit në bazë të elementeve të parapara përmes përmbushjes së këtyre detyrave si vijon: 1) Planifikim dhe vlerësim i procesit mësimor 2) Punë kërkimore-shkencore, Vepra artistike 3) Shërbimet Administrative dhe 4) Shërbimet për shoqëri.

- *Kalendari vjetor për Sigurim të Cilësisë*

Kalendari vjetor përmban të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me sigurim të cilësisë në UKZ. Planifikimi i aktiviteteve është bërë në baza javore, ku janë paraparë përgjegjësit për secilin aktivitet.

3. Funkcionalizimi i zyrës për Hulumtime Shkencore

Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, përmes projektit ResearchCult, ka funksionalizuar zyrën për Hulumtime Shkencore, në të cilën ka emëruar koordinatoren e zyrës. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj zyre është që të mbështesë rritjen e kulturës kërkimore në UKZ duke rritur politikën dhe praktikën ekzistuese.

Gjatë viti 2021 gjithsej janë realizuar 47 punime shkencore nga stafi akademik i UKZ.

Mbështetje financiare: për 18 profesorë **dhe 24 punime shkencore, me vlerë prej 15,500.00 €.**

4. Studentët

Gjatë vitit 2021, janë realizuar dy konkurse për pranimin e studentëve të rinj, në korrik dhe shtator. Për vitin akademik 2021-2022 janë pranuar gjithsej **677 studentë** në dy nivelet e studimit.

Rënia e përgjithshme e numrit të studentëve.

Rritja e interesimit për shkencat e edukimit, për shkencat kompjuterike dhe për të gjitha programet në studimet master.

Numri total i studentëve të pranuar në UKZ është **9446 (bachelor)+470 (master)= 9916.**

Studentë të diplomuar:

- Edukim: 566
- Juridik: 399
- Ekonomik: 567
- Sh. Kompjuterike: 141
- Total: 1619 (bachelor)+59 (master)=1678

Ndryshorja e madhe midis studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar nuk ndërlidhet me cilësinë e studimeve, por më shumë me aspekte të tjera kulturore: i riu në KS e regjistron një fakultet edhe pa ndonjë bindje se duhet ta kryejë, ose e regjistron për nevojë të tjera personale, si është emigrimi.

Numri aktiv i studentëve gjatë vitit 2021 ka qenë 1972 (bachelor)+238 (master)=2210.

UKZ ka ofruar bursa për studentët e shkëlqyeshëm: 77 studentë janë përfitues të bursës për vitin 2021, në një vlerë prej 61,600.00 €.

5. Stafi i ri akademik

Gjatë vitit akademik janë bërë edhe disa përparime, sado jo të mjaftueshme, për pranimin e stafit të ri akademik.

6. Projektet e reja ndërkombëtare

Hapësira e bashkëpunimit ndërkombëtar është zgjeruar edhe më tepër. Edhe gjatë vitit 2021, përkundër vështirësive pandemike, UKZ është pjesë e 3 projekteve të reja në ERASMUS+, si parntere.

Mobiliteti i stafit dhe studentëve, falë angazhimit të zyrës për bashkëpunim ndërkombëtar këtë vit është rritur dukshëm. Nga të gjitha njësitë akademike dhe administrative, stafi ka lëvizur në trajnime dhe vizita të ndryshme studimore dhe ka përfituar përvoja të reja në fushat që ju përkasin.

Universiteti “Kadri Zeka në Gjilan gjatë vitit 2021 ka arritur Marrëveshje bashkëpunimi me 6 universitete rajonale dhe evropiane dhe me 5 institucione private.

7. Ndërtimi dhe renovimi i hapësirave mësimore, laboratorike dhe administrative të UKZ:

1. Ndërtimi i kampusit të Universitetit “Kadri Zeka” në shumë prej 180,000.00 Euro, Pas investimeve të bëra gjatë vitit 2020 dhe të 2021 janë përfituar hapësirë shtesë punuese në sipërfaqe mbi 746 m².
2. Renovimi dhe zgjerimi i bibliotekës universitare
3. Renovimi i kabinetit të muzikës me vegla të reja muzikore.
4. Krijimi i një kabineti të ri për shkencat kompjuterike dhe renovimi i bodrumit, me ndihmën e KFOR-it turk.
5. Renovimi i një pjese të zyrave të administratës.

Përfundim:

- Rezultati i përgjithshëm i UKZ në vitin e dytë pandemik Covid 19 është shuë pozitiv.
- Është koha përfundimtare që sidomos Komuna e Gjilani, po edhe komunat përreth, si dhe Qeveria e Kosovës të gjejnë zgjidhje për hapësirat e reja për UKZ. Objekti ekzistues mezi i mbulon minimumin e nevojave për punë. Është koha që Gjilani dhe gjilanasit të kuptojnë të qenët qytet universitar dhe qytet jo-universitar ka dallim si nata me ditën.
- Në vitin 2023 UKZ ka jubileun e parë: mbush dhjetë vjet. Ju ftoj nga sot, sidomos studentët dhe stafin akademik, që në jubileun e dhjetë të prezantojnë më gjerësisht aktivitete dhe rezultate të tyre.

Na priftë e mbara!